



KUVENDI KOMUNAL PRISHTINE * MUNICIPALIT ASSEMBLY PRISHTINA * SKUPSTINA OPSTINA PRISTINA

Në bazë të nenit 10.1. të Ligjit për mbrojtjen e ajrit, Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2004/48, të dispozitave të nenit 40, paragrafi 1, shkronja (d) të Statutit të Komunës së Prishtinës, të dt. 16.3.2001, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 03.10.2006, miratoi këtë

RR E G U L L O R E PËR MBROJTJEN E AJRIT

I.DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Me këtë rregullore përcaktohet baza juridike për krijimin e një mjedisi më të shëndetshëm, i cili përballon ndotjet dhe shpenzimet për mbrojtje të ajrit nga ndotja dhe që është në përputhje me zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të komunës së Prishtinës (më poshtë e qujtur:Komuna).

Neni 2

Kjo rregullore ka për qellim të rregullojë dhe të garantojë të drejtën e qytetarëve të komunës për të jetuar në një mjedis me ajër të pastër, duke mbrojtur shëndetin e njeriut, florën, faunën dhe vlerat natyrore e kulturore të mjedisit nga ndotja e ajrit.

Neni 3

3.1. Burimet e ndotjes së ajrit janë:

a/ Burimet e palëvizshme, të cilat përfshijnë stabilimentet teknologjike që kanë pajisje të palëvizshme për djegien e lëndëve të ndezshme, pajisjet për procese teknologjike, veprimtaritë nga puna e të cilave mund të shkaktohet ndotja ajrit, magazinimet e lëndëve djegëse, të lëndëve të para, të produkteve dhe mbetjeve;

b/ Burimet e lëvizshme të ndotjes;

c/ Burimet e vogla ndotëse, që cilësohen edhe pajisjet për procese teknologjike që nuk përfshihen në burime tjera të ndotjes, veprimtaritë që shkaktojnë ndotjen e ajrit, magazinimet e karburanteve, të lëndëve djegëse, të lëndëve të para, të mbetjeve dhe ndotësve të grumbulluar;

d/ Burimet difuzive të cilat përfshijnë pajisjet, sipërfaqet dhe hapësirat tjera nga të cilat materiet ndotëse përhapen lirshëm në ajër, pa pasur tymtar apo mjete tjera të shkarkimit.

3.2. Në përputhje me aktin e Qeverisë së Kosovës (më poshtë e qujtur:Qeveria), mund të miratohen edhe burime tjera ndotëse që mund të shfaqen si ndotës të ajërit.

TREGUESIT E CILËSISË SË AJRIT

Treguesit bazë

Neni 4

4.1. Treguesit bazë të mjedisit, të cilësisë së ajrit, shprehin përqëndrimin të lëndëve të gazta, të ngurta e të lëngëta në ajër, si më poshtë:

- a/ - të lëndës së ngurtë, të grimcave (mjegullës, tymit, pluhurit, blözës),
- b/ - të dioksidit të sulfurit,
- c/ - të monoksidit të karbonit,
- d/ - të azotit,
- e/ - të plumbit, merkurit, arsenit, kadiumit, nikelit dhe të kompozimeve të tyre,
- f/ - të oksideve të azotit,
- g/ - të halogjeneve,
- h/ - të hidrokarbureve (benzeni),
- i/ - rrezatimi jonizues dhe jojonizues,
- j/ - **PM₁₀** (nënkupton grimca 50% e të cilave kalojnë nëpër selektorë me diametër aerodinamik prej 10 mikrometra), **PM_{2.5}** (nënkupton grimca 50% e të cilave kalojnë nëpër elektorë me diametër prej 2.5 mikrometra), **PM₁**.

4.2. Për zona të veçanta dhe varësisht nga natyra e shkarkimeve në ajër, në përputhje me aktin e veçantë të Qeverisë, Kuvendi, me propozim të Drejtoratit të Shërbimeve Publike, Transportit, Mbrojtjes së Ambientit dhe Tokës Ndërtimore, mund të miratojë tregues të tjerë të mjedisit për cilësinë e ajrit.

Neni 5

Në përputhje me aktin e veçantë të Qeverisë, Kuvendi, me propozim të Drejtoratit të Shërbimeve Publike,Transportit, Mbrojtjes së Ambientit dhe Tokës Ndërtimore, si dhe të Drejtoratit të Shëndetësisë dhe të Politikës Sociale, cakton normat e cilësisë së ajrit, të depozitimit dhe normat specifike për zonat e veçanta.

KUFIZIMI I SHKARKIMEVE NË AJËR

Neni 6

Kufizimi i shkarkimeve në ajër realizohet nëpërmjet vendosjes dhe zbatimit të detyrueshëm të normave të shkarkimit, të cilat i miraton Kuvendi me propozim të Drejtoratit të Shërbimeve Publike,Transportit, Mbrojtjes së Ambientit dhe Tokës Ndërtimore, në përputhje me aktin e Qeverisë.

Neni 7

Pajisjet shkarkuese të burimeve të ndotjes duhet të kenë lartësi të tillë që vlerat e treguesit mjedisor të gjendjes së ajrit të mos kalojnë limitin e lejuar të cilësisë për një ndotës të dhënë. Lartësia e pajisjeve shkarkuese caktohet për çdo rast,veç e veç, me lejen e mjedisit.

Neni 8

8.1. Për burimet e lëvizshme, normat e shkarkimeve përcaktohen në bazë të treguesve mjedisor të trysnisë në gazrat e shkarkuara nga këto burime, të cilat janë: përqendrimi i blozës, oksideve të karbonit, oksideve të azotit, hidrokarbureve, plumbit dhe i sulfurit.

8.2 Normat e shkarkimeve nga burimet e lëvizshme i miraton Kuvendi me propozim të Drejtoratit të Shërbimeve Publike, Transportit, Mbrojtjes së Ambientit dhe Tokës Ndërtimore dhe të Drejtoratit të Shëndetësisë dhe të Politikës Sociale, në përputhje me aktin e Qeverisë.

DETYRIMET PËR MBROJTJEN E AJRIT

Neni 9

9.1. Personat fizikë e juridikë kanë detyrë të ruajnë pastërtinë e ajrit, t'a mbrojnë atë nga ndotjet e shkaktuara nga veprimtaria që ushtrojnë në territorin e komunës dhe detyrohen të:

a/ - mbikëqyrin emisionet,

b/ - zvogëlojnë emisionin e ndotësve dhe erërave të pakëndshme,

c/ - mos tejkalojnë vlerat imituese të emisionit.

9.2. Prodhuesit, importuesit, eksportuesit, tregtarët dhe përdoruesit e pajisjeve, prodhimeve, materialeve dhe të substancave që ndotin ajrin, janë të detyruar të ndërmarrin masa që garantojnë mbrojtjen e cilësisë së ajrit.

9.3. Prodhuesit dhe importuesit e burimeve të lëvizshme, prodhojnë dhe importojnë vetëm ato mjete e pajisje që plotësojnë normat e shkarkimeve.

9.4. Burimet e lëvizshme me motorët me djegie të brendshme, i nënshtrohen kontrollit të shkarkimeve të gazeve ndotës sipas rregullave të përcaktuara nga Ministria e Transportit dhe e Telekomunikacionit.

9.5. Prodhuesit, importuesit, eksportuesit, transportuesit dhe tregtarët e lëndëve djegëse detyrohen t'i prodhojnë, t'i importojnë, t'i tregtojnë ato në përputhje me kërkesat e cilësisë, të miratuara nga Qeveria.

9.6. Ndalohet djegia e lëndëve të tjera, të ndryshme nga:

a/ - ato të përcaktuara nga prodhuesi i pajisjes dhe nga ato të përcaktuara me lejen e përdorimit të objektit, të prodhimit e të tregtimit të lëndëve djegëse,

b/ - lëndët djegëse të përcaktuara me parametrat teknike ose në masat tekniko-organizative për vënien në përdorim të burimeve të ndotjes.

9.7. Ndërtimi i stabilimenteve të reja dhe rinovimi i stabilimenteve ekzistuese lejohet vetëm me teknologji ekologjike.

Neni 10

10.1. Operatorët e burimeve të ndotjes detyrohen:

- a/ - t'i përdorin këto burime vetëm sipas kushteve teknike dhe kushteve të dhëna në lejen për mjedisin,
- b/ - të përgatisin rregullore teknike për funksionimin e burimeve të ndotjes,
- c/ - të bëjnë mbikëqyrjen e shkarkimeve në ajër dhe t'i publikojnë periodikisht të dhënat për shkarkimin, si dhe masat e ndërmarra për kufizimin e ndotjes.

10.2. Operatorët e burimeve të ndotjes sigurojnë veprimtarinë normale dhe përgatisin listën e parametrave teknike, operacionalë dhe masat tekniko - organizative për burimet e ndotjes.

Neni 11

Operatorët e burimeve të lëvizshme të ndotjes detyrohen t'i përdorin dhe t'i mirëmbajnë ato në përputhje me kushtet e përcaktuara nga prodhuesi i tyre, në pajtim me normat e shkarkimeve, të respektojnë masat e përcaktuara nga Drejtorati i Shërbimeve Publike, Transportit, Mbrojtjes së Ambientit dhe Tokës Ndërtimore për zonat që kërkojnë mbrojtje të veçantë të cilësisë së ajrit.

ZONAT ME MBROJTJE TË VEÇANTË

Neni 12

Për zonat e shpallura nga Qeveria me mbrojtje të veçantë nga ndotja e ajrit, Drejtorati i Shërbimeve Publike, Transportit, Mbrojtjes së Ambientit dhe Tokës Ndërtimore dhe Drejtorati i Shëndetësisë dhe i Politikës Sociale, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe të Planifikimit Hapësinor dhe Ministrinë e Shëndetësisë, përcaktojnë masa të veçanta për mbrojtjen e cilësisë së ajrit.

PAJISJA ME LEJE TË MJEDISIT E VEPRIMTARIVE QË NDOTIN AJRIN

Neni 13

Personat juridikë e fizikë janë të detyruar që, në bashkëpunim me Drejtoratin e Shërbimeve Publike, Transportit, Mbrojtjes së Ambientit dhe Tokës Ndërtimore, të pajisen me leje të mjedisit nga Ministria, për:

- a/ - ndërtimin dhe shfrytëzimin e burimeve të ndotjes, si dhe për ndryshimet e tyre të mëvonshme,
- b/ - projektimin e tipit standard dhe të projekt-modelit për ndërtimin e burimeve të ndotjes;
- c/ - zbatimin e projekteve ku përfshihen teknologji dhe prodhime të reja burimesh të ndotjes,
- d/ - ndryshimin e standardeve teknike dhe normave të shkarkimeve të gazta nga burimet e ndryshme të ndotjes, kur zbatimi i tyre cenon mbrojtjen e ajrit,
- e/ - ndërtimin e burimeve të ndotjes, kur dokumentacioni i tij nuk miratohet sipas një tipi standard ose projekt-modeli,
- f/ - zëvendësimin e lëndëve djegëse dhe të lëndëve të para që përdor burimi i ndotjes,
- g/ - prodhimin, importimin dhe tregtimin e lëndëve djegëse, pajisjeve fikse, materialeve dhe produkteve që ndotin ose mund të ndotin ajrin,

h/ - ndryshimin e parametrave teknike, operacionalë dhe të masave tekniko - organizative të burimit të ndotjes,

i/ - ndryshimin e veprimtarisë që dallon nga ajo bazë.

Neni 14

Planifikimi i mbrojtjes së ajrit nga ndotja bazohet në Programin komunal për mbrojtjen e ajrit nga ndotja dhe në Raportin për zbatimin e planeve dhe programeve për mbrojtjen e ajrit nga ndotja.

Neni 15

Raporti për zbatimin e planeve dhe programeve për mbrojtjen e ajrit nga ndotja përmban të dhënat për cilësinë e ajrit, ndotësit, tendencat e zhvillimit të emisioneve të ndotësve, matjet lidhur me përmirësimin e cilësisë së ajrit dhe rezultatet nga matjet.

Neni 16

16.1. Programi komunal për mbrojtjen e ajrit nga ndotja definon politikën e mbrojtjes së ajrit nga ndotja dhe menaxhimin e cilësisë së ajrit brenda territorit të komunës, në përputhje me Strategjinë kosovare të mbrojtjes së ajrit nga ndotja.

16.2. Programi komunal për mbrojtjen e ajrit nga ndotja është pjesë integrale e Programit komunal për mbrojtjen e mjedisit. Raportin për zbatimin e Programit, të cilin e harton Drejtorati i Shërbimeve Publike, Transportit, Mbrojtjes së Ambientit dhe i Tokës Ndërtimore, në bashkëpunim me Drejtoratin e Shëndetësisë dhe të Mirëqenies Sociale e shqyrton Kuvendi.

MBIKËQYRJA E CILËSISË SË AJRIT

Neni 17

17.1. Drejtorati i Shërbimeve Publike, Transportit, Mbrojtjes së Ambientit dhe i Tokës Ndërtimore, në bashkëpunim me Drejtoratin e Shëndetësisë dhe të Politikës Sociale, e në përputhje me aktin e veçantë të Ministrisë, zbaton mbikëqyrjen e përhershme të cilësisë së ajrit, si dhe ndikimin e tij në mjedis dhe shëndetin e popullatës në territorin e komunës.

17.2. Pikat monitoruese, numri dhe matjet e shpeshta, klasifikimi i ndotësve të cilët mbikëqyren, metodologjia e punës, forma dhe koha e raportimit të të dhënave caktohen nga Drejtorati i Shërbimeve Publike, Transportit, Mbrojtjes së Ambientit dhe i Tokës Ndërtimore, në përputhje me aktin e veçantë të Ministrisë.

17.3. Subjektet të cilat shkaktojnë ndotjen e ajrit janë të obliguar të organizojnë sistemin e mbikëqyrjes interne, me qëllim të përcjelljes së shkallës së ndotjes.

Mbikëqyrja

Neni 18

Gjatë mbikëqyrjes inspektuese në mbrojtjen dhe përmirësimin e cilësisë së ajrit, me aplikimin edhe të laboratorëve mobilë, inspektori mbikëqyrë:

a/ - zbatimin e masave mbrojtëse të përcaktuara në procedurën e vlerësimit të ndikimit në mjedis,

- b/ - punën e pajisjeve të repartit dhe pajisjeve mbrojtëse në burimet e regjistruara të ndotjes,
- c/ - përmbushjen e vlerave imituese të emisionit dhe zbatimin e masave mbrojtëse,
- d/ - zbatimin e matjes së emisionit dhe hartimin e raportit,
- e/ - zbatimin e programeve sanuese dhe Programit për mbrojtjen dhe përmirësimin e cilësisë së ajrit, dhe
- f/ - efikasitetin e masave për zvogëlimin e ndotjes së ajrit.

FINANCIMI I MBROJTJES DHE PËRMIRËSIMIT TË CILËSISË SË AJRIT

Neni 19

19.1. Mjetet financiare të nevojshme për mbrojtjen dhe përmirësimin e cilësisë së ajrit në territorin e komunës sigurohen nga të hyrat e buxhetit të Komunës, donacionet apo kreditë, në përputhje me dispozitat e Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë.

19.2. Mjetet e siguruar, sipas paragrafit të parë të këtij neni, përdoren:

- a/ - për hartimin dhe zbatimin e programeve dhe masave për parandalimin apo uljen e nivelit të ndotjes së ajrit,
- b/ - për mbrojtjen e qytetarëve të territorit të komunës dhe mjedisit të saj atëherë kur standardet minimale tejkalohen,
- c/ - për hulumtime shkencore e të tjera, që janë të nevojshme për zbatimin e kësaj rregulloreje,
- d/ - për aktivitete tjera të nevojshme për zbatimin e kësaj rregulloreje.

DISPOZITAT NDËSHKUESE

Neni 20

Në kuptim të kësaj rregulloreje, do të konsiderohen shkelje dhe do të dënohen këto veprimtari:

- a/ Ushtrimi i veprimtarive në territorin e komunës, në kundërshtim me nenin 13 të Rregullores, pa lejen e mjedisit dhe dënohet me gjobë prej 1.000 € deri në 10.000 €, dhe me pezullimin e veprimtarisë deri në tre muaj, kohë kjo brenda së cilës subjekti duhet të pajiset me lejen e mjedisit;
- b/ Prodhimi, importimi ose tregtimi i lëndëve djegëse nga subjekti në kundërshtim me nenin 9.5. të Rregullores, dhe dënohet me gjobë prej 1.000 € deri në 5.500 €, varësisht nga sasia dhe rrezikshmëria që paraqesin lëndët djegëse të palejuara. Në këtë rast sekuestrohet lënda djegëse në stoqe;
- c/ Përdorimi i lëndëve djegëse nga operatori, në kundërshtim me nenin 9.6. të Rregullores, dhe dënohet me gjobë prej 1.000 € deri në 10.000 €, varësisht nga sasia dhe rrezikshmëria që paraqesin lëndët djegëse. Në këtë rast pezullohet veprimtaria, për aq kohë sa të bëhet zëvendësimi i lëndës djegëse;

d/ Prodhimi ose importimi i burimeve të lëvizshme të ndotjes, në kundërshtim me nenin 9.3.të Rregullores, që nuk plotëson normat e shkarkimit, dënohet me gjobë prej 500 € deri në 5.000 €, varësisht nga prodhimi dhe importi. Në këtë rast vendoset mbyllja e përhershme e veprimtarisë;

e/ Ndotja e ajrit nga operatori i burimit të ndotjes, i cili shkel normat e shkarkimit në zonat me mbrojtje të veçantë, smogu ose emergjence, kushtet teknike dhe kërkesat e përcaktuara në lejen e mjedisit dhe dënohet me gjobë prej 1.000 € deri në 10.000 €, varësisht nga lloji dhe sasia e shkarkimeve ndotëse, si dhe me ndërprerjen e veprimtarisë së burimit ndotës për aq kohë sa operatori të sjellë shkarkimet në norma të lejuara.

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 21

Kjo rregullore hyn në fuqi në ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Prishtinës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01 Nr. _____ , më _____ 2006

KRYETARI I KUVENDIT
Ismet Beqiri